



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKA
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Ne bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", neneve 15, 29, pika 2 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, e në mbështetje të nenit 13, të Rregullores mbi ndarjen e bursave për nxënës/e dhe student/e, të Komunës së Suharekës, 01-Nr-16-540, Kuvendi i Komunës në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur me datën 29.05.2026, miratoi këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit

Neni 1

Formohet komisioni nga anëtarët e Kuvendit të Komunës në Suharekë, për shqyrtimin e ankesave që paraqiten kundër vendimeve të komisionit për ndarjen e bursave, me këtë përbërje:

1. Aziz BYTYQI-----përfaqësues nga Kuvendi i Komunës--anëtar
2. Dorentina ZENELAJ----përfaqësuese nga Kuvendi i Komunës--anëtare
3. Qendrim ELSHANI-----përfaqësues nga Kuvendi i Komunës---anëtar
4. Jehona RRAFSHI-LUMI---përfaqësuese nga Kuvendi i Komunës--anëtare
5. Afërdita MAMAJ-----përfaqësuese nga Kuvendi i Komunës---anëtare

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit për shqyrtimin e ankesave, që paraqiten kundër vendimeve të komisionit për ndarjen e bursave, janë që të shqyrtojnë dhe të vendosin për ankesat e paraqitura.

Neni 3

3.1 Për punën që do ta kryej komision do të kompensohen nga 50€, për çdo mbledhje (seancë) që do ta mbajë.

3.2 Anëtarët e komisionit të lartcekur nuk mund të paguhën më shumë se 6, (gjashtë) mbledhje (seanca) të cilat mbahen brenda viti kalendarik.

Neni 4

4.1 Mandat i anëtareve të komisionit komunal të ankesave zgjat aq sa zgjat mandati i rregullt i ligjor i anëtarëve të Kuvendit të Komunës në Suharekë.

4.2 Kuvendi i Komunës në Suharekë, e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtareve të komisionit kur do herë që kërkohet.

Neni 5

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 30, ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9, të Ligjit Nr. 08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024" dhe neni 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, (QRK) Nr. 03/2026, për procedurat e shqyrtimit administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr- 410-24516
Me datë 29.05.2026



Kryesuesi i Kuvendit
[Signature]
Mr.ec/Bexhet KUÇI